

**Tiranë, më 16.11.2018**

### **Njoftim për shtyp**

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku vijoi shqyrtimi i ankimit të paraqitur nga ky institucion kundër vendimit nr. 22, datë 7.6.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë për subjektin e rivlerësimit z. Edmond Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Komisioneri Publik në fillim të seancës gjyqësore kërkoi që Kolegji i Posaçëm i Apelit të vendosë lidhur me kërkesën për riçeljen e një hetimi tërësor ose të pjesshëm, me qëllim marrjen e provave për secilin nga shkaqet e ankimimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Pasi u tërhoq për vendim, në vijim të seancës gjyqësore, trupa gjyqësore e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendosi riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor, për marrjen e provave të kërkuara në ankimin e Komisionerit Publik dhe caktoi zhvillimin e seancës gjyqësore të radhës, më datë 11.12.2018.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi dhe parashtrimet e çështjes janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: [www.ikp.al](http://www.ikp.al).

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.